

Fjalim i deputetit Vangjel Dule

13.07.2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtoreshë e INSTAT-it, Thembra e Akilit në regjistrimet e mëparshme të popullsisë në vendin tonë ka qenë regjistrimi i pjesëtarëve të minoriteteve etnike dhe komuniteteve fetare. Ju pyeta se çfarë keni menduar për përfshirjen e tyre në administrimin e procesit, me idenë se do të isha më i informuar, më i qetë dhe më i sigurt, sepse edhe ky aspekt do të merrte një zgjidhje përfundimtare dhe të besueshme, por nga përgjigjja që mora nuk dola optimist. Pse? Shikoj që nuk e keni vënë ujin në zjarr për trajtimin e këtij problemi. Ka mosbesim të dyanshëm. Ku qëndron mosbesimi?! Ju, si institucion, nuk operoni me një mentalitet europian, që ta konsideroni censin si një instrument, keni fobi; keni fobi nga produkti që do të sjellë përdorimi i këtij instrumenti, në një kohë kur duhet të ishit të parët që të sillnit mesazhe civilizuese, madje edhe për politikën. Nuk ju vjen asgjë e keqe nga kjo gjë, përkundrazi, ka vetëm anë pozitive.

Duhet të bëhet “inventarizimi i popullsisë”, nëse ky është termi i përshtatshëm, që ta dimë se kush është kush. Ne si politikanë e duam produktin tuaj, që të dimë se si do t’i implementojmë ato detyrime në politikat tona për pjesëtarët e minoriteteve; ku jetojnë ato tradicionalisht; sa është numri i komuniteteve të tyre. Ju sërish nuk do të na jepni një produkt të besueshëm. Pse? Pas 2 vjetëve shtyrje të censit, na thoni, se ende nuk e keni bërë publik pyetësin e tij, sepse nuk e keni detyrim ligjor. A nuk keni qenë në atë institucion për debatet që u bënë për këtë të shkretë pyetësor?! Ky pyetësor në vitin 2001 nuk përmbante pyetje në lidhje me përkatësinë etnike, gjuhën amtare dhe afilimin fetar; në vitin 2011 këto u përfshinë, por me klauzolat e gjobëvënies.

Tani, vijmë në një moment tjetër, kur ligji i ka kapërcyer këto. A nuk duhet të ishit ju pararendës të një fryme të re, konstruktive? A i keni përfshirë komunitetet e minoriteteve në një dialog? A jeni përpjekur t’i përfshini, t’i rekrutoni, që të jenë pjesë e stafit në nivele të ndryshme për censin e ardhshëm? Jo. Me sa kuptoj, nuk e keni bërë. Jemi 2 muaj, pas 2-3 ditësh, përpara fillimit të censit dhe ligji ju detyron të filloni informimin publik dhe sensibilizimin publik. Kur do ta bëni, nëpër plazhe, gjatë muajit gusht?!

Zonja drejtoreshë, ju lutem, nuk është ende vonë që të ndërmerri hapa rregullues të këtyre aspekteve, të cilat janë domethënëse, nuk janë dytësore. Përfshini grupet e interesit, përfshini minoritetet me përfaqësuesit e tyre, që përfundimisht të kemi një cens europian, si në çdo vend tjetër; të mos jemi më vendi që nuk kemi bërë, si shumë gjëra të tjera, një cens të gjithëpranuar.

Ne kemi bërë një cens që nga ana statistikore (dhe ju duhet të ishit të parët të shqetësuar) komunitetin e besimtarëve ortodoksë e ka nxjerrë 6%, pra pothuajse 4 herë më pak se regjistrimet e paraluftës dhe të pasluftës. Me këto procedura dhe me këtë mentalitet që unë konstatova, të paktën në përgjigjet që iu dhatë pyetjeve të mia, nuk shikoj se diçka ka ndryshuar. Prandaj, shfrytëzoheni kohën që keni deri në fillimin e këtij procesi; operoni me një frymë profesioniste dhe statistikore; na jepni ne politikanëve atë që ju thashë në fillim instrumentin e duhur për të ushtruar politika adekuate. Largojuni stereotipeve! Largojuni paragjytimeve! Duhet të jeni të parët. Largojuni fobive!

Faleminderit!

XXXXXXXX

– Faleminderit, zonja Kryetare!

Kam thjesht një replikë të shkurtër me zotin Shalsi.

Unë e vlerësoj gjithmonë për ndërhyrjet e tij se janë informuese, moralizuese, këshilluese dhe të pranuar, por reflektimi që më provokoi në këto sekuenca kohore më bën edhe më të shqetësuar në lidhje me fatin e “thembrës së Akilit”, që thashë edhe më parë, të censusit. Kemi dy cense të dështuara në aspektin e regjistrimit të pjesëtarëve të minoriteteve dhe të komuniteteve fetare. Në asnjë rast kjo nuk duhet të na vërë në gjumë se e kemi përgatitur mbarë kësaj here, por duhet të jemi në alert të vazhdueshëm që censusi i ardhshëm të mos jetë në të njëjtën rrjedhë.

Edhe në vitin 2001 ishte nën vëzhgimin e Komisionit Europian dhe me financim të huaj. E njëjta gjë edhe në vitin 2011, ishte i dështuar. Ne duhet të bëjmë çmos, dhe, natyrisht, nuk e kam diskutimin tim për të akuzuar apo për të vënë përpara përgjegjësisë, por për të inkurajuar, sepse sot që flasim mund të ketë patur kontakte, mund të ketë patur konsultime. Me përfaqësues zyrtarë të shoqatave përfaqësuese kryesore të minoriteteve nuk ka patur, por ka patur me përfaqësues periferikë dhe me synim, këtë nuk mund të mos e karakterizoj si politikë, për të shmangur përfaqësues të mirëfilltë apo përfaqësim gjithëpërfshirës të tyre për të qenë më objektiv.

Faleminderit